



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 5559/1 prot.

Shkodër, më 7.08.2026

Lënda: Mbi Vendimin nr. 52 , datë 30.07.2026 të Këshillit i Bashkisë Vau Dejës

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 84/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, të shkresës së Këshillit të Bashkisë Vau Dejës , nr. 5554 datë 04.08.2026, *shqyrtoi vendimin nr. 52 datë 30.07.2026 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes bashkisë Vau Dejës nr.4851 prot, datë 30.06.2026 dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) nr.11 prot datë 29.06.2026 Për bashkëpunim ndërinstitutional për përgaditjen dhe përdorimin nga bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”.*

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni duke përcaktuar burimin e financimit prej 200 00 lekë nga bashkia Vau-Dejës, për përgaditjen e materialit analitik dhe publikimit, në zbatim të nenit 5 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
[Signature]
Holta DUDA



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 52 Datë. 30.07 2026

“Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 “Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”

Në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ndryshuar; Ligji Nr.84/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”; Udhëzimin Nr.02, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit 2026”; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.74, datë 23.12.2026 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”; Shprehjen e Ligjshmërisë nga Prefektura Shkodër me Nr.884/1 Prot, datë 07.01.2026; VKB Nr.76, datë 23.12.2025 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026”; Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 “Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025” (Bashkëngjitur marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr. 4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026).



2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas përcaktimit të nenit 55 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT
Ervis SHIMAJ



SEKRETARI I KËSHILLIT
Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 20 vota
Vota pro 20
Vota kunder
Vota Abstenim
Zbardhur me datë 09.08.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETETEVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 10 Datë. 14 . 07 2026

“Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 “Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ndryshuar; Ligji Nr.84/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”; Udhëzimin Nr.02, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit 2026”; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.74, datë 23.12.2026 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”; Shprehjen e Ligjshmërisë nga Prefektura Shkodër me Nr.884/1 Prot, datë 07.01.2026; VKB Nr.76, datë 23.12.2025 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026”; Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026, ku në mbledhjen e datës ____/____/2026 të Këshillit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 “Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025” (Bashkëngjitur marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr. 4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika 6, e ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Konceptoi/Specialiste Sektori Ligjor

Ersilda Preka

Miratoi/Drejtor

Marinela Deda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJES

Lënda: Relacion shpjegues mbi miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 *“Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”*.

Mbështetur në zbatim të *“Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*; të ndryshuar; Ligji Nr.84/2025 *“Për buxhetin e vitit 2026”*; Udhëzimin Nr.02, datë 14.01.2026 *“Për zbatimin e buxhetit 2026”*; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.74, datë 23.12.2026 *“Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”*; Shprehjen e Ligjshmërisë nga Prefektura Shkodër me Nr.884/1 Prot, datë 07.01.2026; VKB Nr.76, datë 23.12.2025 *“Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2026”*; Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026.

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërinstitucional për përgatitjen dhe përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të botimit *“Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”*, si material analitik dhe referues për nevojat e saj institucionale.

Sa më lart, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës duke konsideruar propozimin e bërë u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë:

1.Të miratohet *“Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.4851 Prot, datë 30.06.2026, dhe Institutit për Bashkitë e Shqipërisë (IBSH) Nr.11 Prot, Datë 29.06.2026 “Për Bashkëpunim Ndërinstitucional për Përgatitjen dhe Përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të Botimit Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”*.

Ju faleminderit!

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Aleksandra Gjoni



KRYETARI
Kristian Shkreli

Konceptoi/Specialiste Sektori Ligjor
Ersilda Preka
Miratoi/Drejtor, Sektori Ligjor
Marinela Deda



Nr. 4851 prot.

Vau Dejës, më 30.06 .2026



Nr. 1100 prot,

Tiranë, më 19.06 .2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim "Marrëveshja") lidhet ndërmjet:

Bashkia Vau Dejës, me NIPT K567050070, me adrese: rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Shkoder, përfaqësuar me Zv/Kryetar, Zj. Aleksandra Gjoni, identifikuar në vijim si "**Bashkia**";

Dhe

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë (IBSh), me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Agron Haxhimali në vijim "IBSh"

të cilat në vijim do të referohen së bashku si "Palët".

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje lidhet në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton kompetencat e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, planifikimit strategjik dhe transparencës, si dhe të Ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. a) përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit; b) zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit; c) të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë, si dhe format e tjera, të rrjedhura prej tyre; ç) kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin e buxhetit.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi ndërinstitucional për përgatitjen dhe përdorimin nga Bashkia Vau Dejës të botimit “Qeverisja Vendore në Shqipëri 2025”, si material analitik dhe referues për nevojat e saj institucionale.

Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë së qeverisjes vendore.

Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore në vendimin e buxhetit vjetor, deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen 8 ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore. Fondi i kontingjencës mund të krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit vendor janë në terma bruto.

Neni 3

Qëllimi dhe Interesi për Bashkinë

Kjo marrëveshje synon të mundësojë sigurimin e një instrumenti profesional analize, i cili i shërben Bashkisë Vau Dejës në përmirësimin e proceseve të planifikimit dhe vendimmarrjes, në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe në përdorimin e të dhënave të strukturuar për qëllime zhvillimore. Materiali i përfituar do të shërbejë si dokument reference në hartimin e politikave vendore, në përgatitjen e aplikimeve për fonde dhe projekte, si dhe në forcimin e bashkëpunimeve ndërinstitucionale, duke kontribuar gjithashtu në promovimin e Bashkisë në publikime me karakter kombëtar.

Neni 4

Angazhimet e palëve

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, IBSh angazhohet të përgatisë dhe publikojë botimin sipas standardeve profesionale, duke përfshirë në të edhe të dhëna dhe analizë të dedikuara për Bashkinë Vau Dejës, si dhe të mundësojë përdorimin e këtij materiali nga Bashkia për qëllime institucionale. IBSh merr përsipër gjithashtu të sigurojë përfshirjen e Bashkisë në publikim dhe në materialet shoqëruese, si dhe të vërë në dispozicion produktin final.

Bashkia Vau Dejës angazhohet të bashkëpunojë në sigurimin e informacionit të nevojshëm për realizimin e analizës dhe të përdorë materialin e përfituar në funksion të zhvillimit vendor, planifikimit strategjik dhe aplikimeve për projekte dhe financime.

Neni 5

Vlera dhe Pagesa

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Bashkia Vau Dejës kontribuon me shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë, si financim për përgatitjen e materialit analitik dhe publikimit.

Pagesa kryhet në përputhje me procedurat financiare në fuqi, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Neni 6

Përdorimi i Produktit

Produkti i realizuar në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të përdoret nga Bashkia Vau Dejës si material reference për proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes, si dokument mbështetës në aplikime për financime dhe projekte zhvillimore, si dhe si instrument analize dhe raportimi institucional.

Neni 7

Transparenca dhe Verifikimi

Palët angazhohen të veprojnë në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ndërsjellë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Bashkia ka të drejtë të kërkojë informacion mbi realizimin e objektit të marrëveshjes dhe përdorimin e produktit të përfituar.

Neni 8

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët dhe mbetet në fuqi deri në përfundimin e plotë të realizimit dhe dorëzimit të produktit final..

Neni 9

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve dhe, në rast të pamundësisë, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe hartohet në katër kopje origjinale me vlerë të barabartë juridike, nga dy për secilën palë.

BASHKIA VAU DEJËS

ZV/ KRYETAR

Aleksandra Gjoni



INSTITUTI PËR BASHKITË E

SHQIPËRISË (IBSH),

Drejtor Ekzekutive

Z. Agron Haxhimali

